



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 5454 prot.

Shkodër, më 7 3. 2025

**VENDIM**

**Nr. 17, datë 03.03.2025**

**“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, TË PASURISË  
ME NR.3/455,VOL 30,FQ 142, GJYKATA E RRETHIT SHKODËR, NGA MINISTRIA E  
DREJTËSISË, TEK BASHKIA SHKODËR”.**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 03.03.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1.2, te ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; nenit 3, pika a, nenit 5, nenit 17 të ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, VKM Nr.500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; Udhëzimit Nr.15, datë 30.06.2003 “Për menyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike, si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

**VENDOSI :**

1. Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Shkodër të pasurisë me këto të dhëna:
  - Gjykata e Rrethit Shkodër, pasuria me Nr.3/455,vol 30, Zona Kadastrale Nr.8594 Shkodër me sipërfaqe totale prej 608 m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtese 537 m<sup>2</sup>, e cila është nën përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë referuar kartelës së pasurisë.
2. Fusha e përdorimit për këtë pasuri që kërkohet të tranferohen, do të jetë prona të cilat përdoren për kryerjen e funksioneve administrative.

Adresa: Rr. “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)

3. Të ndiqen procedurat përkatëse sipas legjislacionin në fuqi, pas miratimit të kërkesës nga Këshilli Bashkiak Shkodër për ndryshimin e pronësisë të pasurisë të sipërcituar duke bashkërenduar punën me Ministrinë e Drejtësisë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 31 vota

Vota Pro	31
Vota Kundër	1
Vota Abstenim	1
Zbardhur me datë	04.03.2025

**SEKRETARE**

**Sabina Danaj**



**KRYETAR**

**Oltion LULLI**

